



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 53/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, me ligjin nr.05/L-068 dhe me ligjin 05/L-92, në përbërje prej z.Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – referues, z. Blerim Dina anetar, z. Ekrem Salihu – anetar dhe z. Goran Milenković – anetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “**Ledi Med**” nga Prishtina, kundër autoritetit kontraktues “Qendra Klinike Universitare e Kosovës”, lidhur me aktivitetin e prokurimit, për tenderin me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike – lot 1, 2, 3, 6 dhe 7, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, me dt. 22. mars. 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik: “**Ledi Med**”, nga Prishtina, me nr. 53/17, parashtruar kundër autoritetit kontraktues “Qendra Klinike Universitare e Kosovës”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike – lot 1, 2, 3, 6 dhe 7, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, si pjesërisht e bazuar.
- II. Anulohet**, vendimi, njoftimi për dhenje të kontratës i Autoritetit Kontraktues / Qendra Klinike Universitare e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike – lotet 1, 2, 3, 6 dhe 7, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, si i pa bazuar.
- III. Obligohet**, Autoritetit Kontraktues / Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që lotin 1, 2, 3, 6 dhe 7, të aktivitetit të prokurimit me titull: “Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e paisjeve radiologjike, me nr. të Prokurimit: 701/16/097/211, ti kthej në ri-vlerësim.

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues “Ledi Med, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, megjithatë obligohet i njëjti që në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve - sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

AK-QKUK ka bërë njoftimin për kontratë në KRPP është bërë me 06.09.2016, procedurë e hapur, vlera kontratës shërbim me vlerë të mesme. Afati për ofertim pas përmirësimit të disa gabimeve është bërë me 03.10.2016, gjithashtu me njëjtën datë është bërë hapja e ofertave.

Për këtë aktivitet kanë aplikuar gjithsej 5 OE, për lotet 1 deri në 7.

Pasi tani lënda për këtë aktivitet sipas vendimit të OSHP është kthyer në ri-vlerësim, AK-QKUK ka formuar komisionin rivlerësues prej 3 anëtar, ashtu që me datë 13.02.2017 është bërë data e vlerësimit.

Sipas raportit të komisionit ri-vlerësues OE-të të rekomanduar sipas loteve janë :

Për lot.1, 2, 6 dhe 7 është rekomanduar OE:”Medica.

Për lot.3 është rekomanduar OE:”Med Brand”.

Pas njoftimit për dhënie të kontratës OE“Ledi Med”, me seli në Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: **23.02.2017**, me Nr. **53/17**, kundër njoftimit për dhenje të kontratës, për lotet 1, 2, 3, 6 dhe 7, të këtij aktiviteti të prokurimit , duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së në fuqi , siç janë:

- Neni 6, 7, 41, 59, dhe 71 të LPP-së.

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së në fuqi, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar pretendimet ankimore të përfshira në ankesë, të OE “Ledi Med” – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 13.03.2017, ka sqaruar – trajtuar pretendimet e përfshira në ankesë, rrjedhimisht ka arsyetuar propozimin e tij për kthim në ri-vlerësim të loteve 1, 2, 3, 6 dhe 7, të këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës: 22.03.2017, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues, përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik ankues, përfaqësuesit e operatoreve ekonomik të rekomanduar për dhenje të kontratës pas ri-vlerësimit të ofertave, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, raporti i vlerësimit dhe ri-vlerësimit të ofertave, si dhe deklaratat e palëve pjesëmarrëse në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore fjala ju dha përfaqësuesit të OE ankues "Ledi Med" i cili deklaroi: "Dua të cek se raporti – vendimi i parë për këtë lëndë i datës 19 Janar, ka kërkuar që AK të kërkojë sqarime shtesë për pikat, si për referencë dhe raporti i pranimit nga QKMS dhe Spitali "Euro Med". Neve kur jemi eliminuar herën e dytë, pas rivlerësimit, kemi bërë kërkesë të AK, për rishqyrtim, mirëpo para kësaj i jemi drejtuar me një e-mail "Qendrës së Mjekësisë Sportive", z.Shkelen Rexhaj, qendër që veç na ka lëshuar këtë letër referencë për cilën AK, thirret se është e falsifikuar. Ne me datë 15.02.2017, kemi marr përgjigje nga z.Rexhaj, i njëjti e-mail ka shkruar në "CC" tek QKUK, i cili ka konfirmuar se shkresa-referenca të cilën ma keni dërguar kopje në këtë email, e njëjta më është prezantuar edhe nga organet e hetuesisë, andaj siç jam deklaruar në hetuesi edhe tani konfirmoj se shkresa-referenca në fjalë për projektin e cekur më lart është lëshuar nga qendra jonë. Për çfarëdo paqartësie lidhur me këtë mund të na kontaktoni.

Këtu kam të printuar komplet emailin e z.Rexhaj, letra e lëshuar e referencës, dhe një shënim zyrtar e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të cilët veç kanë bërë verifikimin e kësaj letre me kërkesë të QKUK-së. Konfirmimin e njëjtë për referencë dhe raport, me email e kam marr edhe nga Spitali "Euro-med", nga z. Lart Jakupi. Këto të dhëna i kemi dërguar AK-së, në kërkesën tonë për rishqyrtim, mirëpo prapë nuk janë marr për bazë. Dua të cek se në eliminim është cekur se referenca ka dy vula, duhet të sqarojë se vula e lartë është vule e noterit. Në bazë të kësaj ne kemi kërkuar dhe kërkojmë të bëhet rivlerësim nga QKUK, pasi këto dokumente janë veç të verifikuara dhe vërtetuara".

Përfaqësuesit të AK-QKUK z.Cenaj i cili deklaroi: "Bazuar në vendimin e fundit të OSHP-se, ku obligon AK-në, të bëjë rivlerësim, AK e ka bërë rivlerësimin e ofertave në pajtim me nenin 72, kemi kërkuar përgjigje për referencat, kjo ka qenë kontestuese në atë kohë. Si përfundim e ka eliminuar OE ankues për shkak se nuk i ka referencë si është kërkuar në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit. Sa i përket ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, kofnrom nenit 59 të LPP –së AK ka vepruar sipas kërkesave në dosje dhe njoftim për kontratë. Kemi marr edhe një interpretim nga KRPP si duhet vepruar AK, ku thonë se "AK do ta konsideroj një tender të përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë".

AK ka kërkuar nga spitali “Euro Med”, që të jap sqarime për referencën e prezantuar, dhe spitali nuk është përgjigjur konform afateve, dhe i kemi kërkuar edhe OE-se sqarim. OE, ka ofruar letra kontradiktore, mirëpo baza e gjithë kësaj është se kemi kërkuar ta dëshmojnë me pagesë, dhe OE, kur ka ofruar raportin e bankës del se vetëm 2,913 €, i janë paguar dhe atë pasi janë hapur ofertat në QKUK me datë 12.10.2016, ndërsa në kontratë i figuron 16,550€. Sa i përket referencës tjetër nga Qendra Mjekësisë Sportive, edhe sikur të ishte ashtu, ajo qendër nuk ka pajisje radiologjike, dhe kërkesa jonë ka qenë për servisim të aparaturave të ngjashme. Vërtetësinë e asaj referencë pasi ka kërkuar paneli nga z.Rexhaj, se a ka lëshuar këtë referencë, i njëjti nuk është përgjigjur dhe i kemi shkruar prapë si AK.

Në përgjigje të pyetjes tonë z.Rexhaj ka thënë “lidhur me shkresën e tuaj 18.01.2017 për sqarim nga ana ime, lidhur me përgjigje në kërkesë të OSHP ju sqaroj si në vijim : unë lidhur me këtë kam dhënë përgjigje juve si institucion përgjegjës në emailin e datës 24.10.2016”. Në këtë email thuhet “kompania” Ledi Med”, ka bërë servisimin e pajisjeve në qendrën Kombëtar të mjekësisë sportive, por letër referencë nuk i kemi lëshuar asnjëherë kësaj kompanie. Letra e prezantuar nuk është lëshuar nga ana jonë dhe po ashtu nuk është nënshkruar nga unë”. Këtë person e kemi ballafaquar me komisionin vlerësues dhe prapë ka insistuar se nuk është nënshkrimi i tij, thotë se nënshkrimi tij nuk është Sh.Rexhaj. Pajisja bio mjekësore ka bërë letër zyrtare tek unë si ZKP, për të verifikuar tubin e ndërruar - të vjetër që ka instaluar” Ledi Med”. Ne i jemi drejtuar me shkresë prodhuesit, i cili në përgjigje ka thënë “ky tub nuk është i ri por ka qenë i instaluar diku tjetër, dhe OE, na ka instaluar tubin e vjetër – të përdorur”. Ne kemi qenë të mashtruar gjatë asaj periudhe që kemi pas këtë kontratë, andaj qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe kërkojmë nga panelit hedhë poshtë ankesën dhe të vazhdoj AK më tutje me vazhdim të procedurave”.

Eksperti shqyrtues deklaroj: “Ne i kemi trajtuar dhe sqaruar pretendimet ankimore përmes raportit, poashtu kemi arsyetuar propozimin për rivlerësim të loteve të ankimuar nga OE ankues. Arsyeja kryesore për rivlerësim për këto lote sipas meje është se rivlerësimi paraprak i ofertave nuk është bërë sipas vendimit të paneli shqyrtues të OSHP-së me nr. 402/16. I njëjti vendim ka obliguar AK-në që me rastin e rivlerësimit të ofertave të veprojnë në pajtim me nenin 72 të LPP-së, lidhur me referencat e OE edhe tani ankues, si dhe përgjegjshmërinë e këtij OE, duke veçuar referencat e lëshuara nga” Euro Med”. Pra arsyetimi i të njëjtit vendim potencon se “paneli shqyrtues nuk pati provë apo fakt që dëshmon të kundërtën, edhe përkundër se të njëjtat nuk përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për të aprovuar apo jo një referencë të tillë”. Do thotë, kam bërë krahasimin mes këtij vendimi dhe letrës standarde kundrejt ankuesit, ku arsyetimi i letrës nuk përmban të dhëna konkrete për përgjegjshmërinë apo jo të njëjtit OE, në raport me kërkesën e përcaktuar në piken 9.1 të FDT-së. Pra të gjitha pretendimet ankimore janë të përshkruara dhe sqaruara në raportin e datës 13.03.2017, sipas shkesave të lëndës që kam pas në dispozicion dhe sipas dispozita të LPP-së në fuqi”.

Përfaqësuesi i OE “Med Brand” deklaroj: “Nuk di qfar lidhje ka Qendra Kombëtar Mjekësisë Sportive me radiologji, pra nuk ka të bëjnë as me një gjë të ngjashme. Këto kanë Zero të përbashkët. Gjatë procesit të tenderit të hapur, ne bëmë një vizitë në vend – kontrolli

pajisjeve dhe aty hasëm në parregullsi të papara, është një situatë ku patjetër duhet ndërhyrë, kemi të bëjmë me ndërrimin e tubit "CT Somatom Sensation 64". Edhe në eurologun e pajisjes gjetëm që tubi i vendosur nuk është regjistruar në sistem fare, gjë që kjo situatë na bjen konflikt me prodhuesin pasi prodhuesi e pret prej pajisjes në fjalë të kthehet një tub me numra të caktuar pasi e ka vendos vet. Po që se e kthejmë një tub dhe e njëjtat nuk korrespondon ne do bime konflikt me prodhuesin. Nga prodhuesi kemi kërkuar të bëhet një përcjellje dhe prodhuesi na përgjigjet "tubi në fjalë Straton X me numër seria 46446110, nuk është shitur nga ana e "Siemens" në drejtim të Kosovës, por në dhjetor të vitit 2011, tubi i është shitur përdoruesit të fundit në SHBA".

Përdoruesi i fundit nënkupton që prodhuesi kurrë dhe asnjë mënyrë nuk shet tuba në treg të lirë pasi ka procedurë, ku bëhet kërkesa te prodhuesi, jepet numri materialit pjesës, jepet numri serik i pajisjes dhe vendi ku instalohet. Vetëm atëherë prodhuesi dërgon atë pjesë dhe asnjë mënyrë tjetër. Të ju përkujtoj se Med Brand ka marr pjesë edhe në tenderin e para 3 viteve, ku mes tjerash është kërkuar certifikatat e Inxhinierëve që do bëjnë intervenimet në ato pajisje. OE fitues i ka paraqitur të njëjtat se ata inxhinier kanë qenë një herë apo dy në Kosovë, dhe ne si kompani ndihemi të mashtruar. Andaj ka mundësi ti ofroj këtë dokument panelit shqyrtues, emali nga kompania "Siemens".

Përfaqësuesit të OE"Medica" deklaroj: "Kontrata me "Euro Med", pas qasjes në dokumente pranë QKUK kemi hasur në një dokument kontratë për servisim dhe mirëmbajtja e aparaturës mjekësore e lidhur mes spitalit "Euro Med" dhe OE ankues. Ne konsiderojmë se kjo kontratë e lidhur me 30.01.2015, nuk plotëson kriteret juridike për tu konsideruar si kontrata valide. Këtë e bazojmë në faktin se për tu konsideruar valide duhet të ketë objektin dhe çmimin, ndërsa në rastin konkret mbi 82% të vlerës së kontratës është kompensim. Andaj kjo kontratë mund të jetë kontratë kompensimi e jo e kryerjes së shërbimeve. Pjesë tjetër e shumës në vlerë 2,913 €, është paguar me datë 12.10.2016, do thotë pas hapjes së ofertave apo më mirë të themi 21 muaj pas lidhje së kontratës. Në aspektin ekonomik çdo pagesë që kalon vitin kalendarik konsiderohet borxh i keq, dhe bazuar në këto konsiderojmë se kjo kontratë nuk është valdie. Ne kundërshtojmë mendimin e ekspertit që mendojmë se nuk ka bërë pasqyrim real të situatës, dhe kërkojmë nga paneli të mbetet në fuqi vendimi i AK-së".

Anëtari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK se. "Ju kemi kërkuar dy kontrata të natyrës së njëjtë në tri vitet e funit, a keni kërkuar vlerën monetare të kontratave dhe referencave". Në përgjigje përfaqësuesi i AK-se deklaroi: "Jo nuk kemi kërkuar vlerë monetare të kontratave".

Anëtari i tjetër i panelit pyeti përfaqësuesin e AK-se. Pasi ceket se OE ankues ka pas disa referenca negative, a mund të na prezantoni ato, dhe a ka qenë arsye e eliminimit. Në përgjigje z.Cenaj deklaroi: "Nuk ka qenë pikë e eliminimit në arsyetim referencat negative të AK-së. Me gjithë se nuk i kemi me vete mund ti sigurojmë panelit pasi ato referenca negative që gjenden në shkresat e lëndës – dosjes".

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e OE ankues për raport pranimin nga “Euro Med”, kush është z. Dardan Jakupi, si menaxher i kontratës. Në përgjigje përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: “Me sa e njohim ne ai është tekniku – radiolog që ka punuar me pajisjen në fjalë. Për çdo defekt apo intervenim gjatë kësaj periudhe aj ka qenë person kontaktues. Letra në fjalë raporti i pranimit është bere me kërkesën tonë në mënyrë që të bëhet pagesa për punën e kryer. Në dosje ka qenë e cekur se OE duhet të dorëzoj referencë, raport pranimi apo çfarëdo dokumenti që tregon për punët e përfunduara për këtë periudhë. Raporti i pranimit që kemi dorëzuar është për “Servisim dhe mirëmbajtje të rezonancës magnetike”, ndërsa letër referenca ka qenë për kontratë tjetër për “Mirëmbajtje të Tomografi e kompjuterizuar CT”. Te pajisjet të QKMS, kur themi natyrës së njëjtë, aty kemi Magnet Terapi, pajisje që punon me njëjtën mënyrë por që përdoret për qëllime tjera, kemi pajise ultrasonike mirëpo atje përdoret për terapi”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorëve ekonomik ankues, shoshitjes së provave dhe deklaratave të palëve gjatë prezantimit të provave në seance, konstatoj se arsyetimi i eliminimit të parashtruesit të ankesës OE “Ledi Med”, i potencuar në letrën standarde pas ri-vlerësimit të ofertave, nuk korrespondon me rekomandimet e dala në vendimin paraprak të PSH-së, nr. 402/16, i datës 17.01.2017, pasi që i njëjti vendim ka obliguar AK-në që me rastin e rivlerësimit të ofertave të veprojnë në pajtim me nenin 72 të LPP-së, lidhur me referencat e OE edhe tani ankues, si dhe përgjegjshmërinë e këtij OE kundrejt kërkesës së paraparë në pikën 9.1, pozicioni 4, të FDT-së, duke veçuar referencat e lëshuara nga “Euro Med”. Ndërsa AK – QKUK, edhe pas rivlerësimit të ofertave nuk e ka qartësuar – konkretizuar përgjegjshmërinë apo pa përgjegjshmërinë e parashtruesit të ankesës OE “Ledi Med”, kundrejt shkresave, pjesë e ofertës së OE ankues, referencat – raportet e pranimit.

Poashtu paneli shqyrtues duke u bazuar në provat shkresore si dhe deklaratave të palëve të prezantuara gjatë seancës dëgjimore lidhur me implementimin e kontratës “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike” me nr. të prokurimit 701-14-049-211 e lidhur në vitin 2014 ku OE ankues sipas deklaramit të palëve gjatë seancës dëgjimore nuk ka përmbush kontratën në pajtim me detyrimet e dala nga kjo kontratë dhe atë si psh.deklarimi i OE” Med brand”se tubi “CT Somatom Sensation 64”është vendosur i përdorur dhe atë i marrur nga një përdorues i fundit në SHBA sepse tubi me nr.46446110 nuk është shitur nga gjermania për Kosovë por për SHBA në vitin 2011 provë shkresa nga **Simens Healthcare GmbH Services dt.08.02.2017**,shkresat e lëndës nga AK si:mos prezenca e personelit të certifikuar nga Turqia në vitin 2016 për servisimin e këtyre aparaturave komunikimi i AK me OE “Siemed”(anëtar i konzorciumit),referenca negative nga AK lidhur me implementimin e kësaj kontrate ,pa rregullsitë e konstatuara nga menaxheri i kontratës, dokumenti se CT6 nuk i është bërë Checkup për 13.800 orë apo për afërsisht 580 ditë,kopjet e errorëve për CT6 dhe CT64,paneli shqyrtues duke marr parasysh shëndetin e qytetarëve dhe interesin publik i rekomandon AK që me rastin e ri-vlerësimit të ketë parasysh dhe të konfirmoj se a qëndrojnë këto shkelje të potencuara gjatë seancës dëgjimore për OE ankues gjatë implementimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit“Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve

radiologjike” me nr. të prokurimit 701-14-049-211 e lidhur në vitin 2014 lidhur me sjelljen profesionale t.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurnuk mund të ushtroj ankesë,
për kompensim dëmi në afatë prej 30 ditësh pas
pranimit të këtij vendimi mund të ngrit kërkesëpadi
në Departamentin për çështje administrative
pranë Gjykatës themelore

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES

z. Tefik Sylejmani

